



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1106/ 2 prot

Datë 07.05.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-00345-04-05-2024, me objekt “Blerje Mjeti per zhvillimin e kanaleve Ujitese (Eskavator)” me fond limit 7,327,692.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK me NIPT L82523203F dhe adresë: Lagjja Luigj Gurakuqi, Bulevardi Aqif Pasha, Hotel Skampa, kati 5 nr.303, Elbasan
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Pogradec me adresë: Lagjja nr 2, bulevardi "Reshit Çollaku", Pogradec

Në datën 04.05.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4052 dhe me nr.1106/2024 prot., datë 07.05.2024 e operatorit ekonomik “Arteo 2018” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-00345-04-05-2024, me objekt “Blerje Mjeti per zhvillimin e kanaleve Ujitese (Eskavator)” me fond limit 7,327,692.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;” Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK kundërshton me anë të ankesës me numër ankimi elektronik A/2024/4052 dhe me nr.1106/2024 prot., datë 07.05.2024.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Nuk është paraqitur i gjithë dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në DST. Konkretisht: - Nuk permbush piken 2.3.2 të DT “Operatori Ekonomik duhet të paraqese autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë për llojin e mjetit të ofruar”, pasi autorizimi i paraqitur nuk është origjinal por fotokopje. OE ka paraqitur vertetim perkthimi dhe jo vertetim noterizimi (Njehsim me origjinalin) nga noteri.

- Nuk permbush piken 2.3.3 të DT “Operatori ekonomik duhet të paraqese për mjetin që oferton, llojin e tij (marka, modeli, viti i prodhimit, numri i identifikimit të tij) të shoqëruar me foto nga të gjitha anët dhe me dokumentacionin përkatës (katalog/skedë teknike/librezë/leje qarkullimi), në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e parametrave teknike të mjetit me specifikimet teknike të kërkuara nga AK”, pasi nga ana e OE nuk është paraqitur asnjë document identifikues I mjetit (katalog/skede teknike/ libreze/ leje qarkullimi), që të deshmoje origjinalitetin e tij, lidhjen e tij me prodhuesin. Ne permbushje të kesaj pike, OE ka paraqitur nje document te fotokopjuar, te pa njehsuar me origjinalin, te shoqeruar me vertetim perkthimi dhe që nuk deshmon asnjë lidhje me prodhuesin, nga I cili është marre autorizimi I prodhuesit.

- Ne specifikimet teknike të paraqitura, mungon viti i prodhimit për mjetin e ofertuar, si dhe nuk permbushen specifikimet teknike, sipas kërkesave të AK. Për sa me siper, oferta e operatorit ekonomik “ARTEO 2018”, shpk është e pavlefshme.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 07.05.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro